

Nëntor
2017

Islami dhe nacionalizmi

ISLAMI DHE NACIONALIZMI: DY POLE TË
KUNDËRTA



Boton:
Shoqata kulturore "Drejtësia"
Revista elektronike nr. 21
Nëntor 2017



Islami dhe Nacionalizmi

1. Islami dhe nacionalizmi: dy pole të kundërta

Nuredin Mustafa

Islami i lejon ndjenjat e thjeshta patriotike, siç janë dashuria ndaj babait, djalit apo familjes, por deri në atë masë gjersa këto ndjenja nuk i kundërvihen bindjes më të lartë të njeriut. Mirëpo, siç e pamë edhe më parë, nacionalizmi nuk ndalet vetëm në këto ndjenja të thjeshta. Ai paraqet një besim socio-politik dhe një mënyrë të jetës së njeriut, i cili synon që në tërësi t'i kontrollojë rrjedhat individuale dhe shoqërore të njeriut. Nga ana tjetër, Islami gjithashtu paraqet një sistem të pavarur shpirtëror, praktik, politik e shoqëror që në vete e përfshinë besimin, prandaj është gjë e natyrshme që ndërmjet tij dhe shkollës së nacionalizmit të vijë deri te konflikti i ndërsjellë.

Për dallim nga religjionet tjera, si krishterimi, budizmi e tjerë, Islami nuk kufizohet vetëm në ritet religjioze dhe në bindjet metafizike. Po të kishte qenë Islami vetëm fe e përkushtimeve, atëherë ai do të mund të pajtohej edhe me nacionalizmin. Mirëpo Islami është fe me pikëpamje sociale dhe filozofike që i merr parasysh edhe parimet ekonomike dhe politike. Nga ana tjetër, edhe nacionalizmi i ka parimet e veta sociale dhe politike, por të bazuara në besime të ndryshme. Për këtë arsye, konflikti midis Islamit dhe nacionalizmit është i pashmangshëm. Ideologjia islame nuk është e kompatibile me asnjë ideologji tjetër përkitazi me pacenueshmërinë e jetës private dhe shoqërore të muslimanëve. Nuk është e mundur që muslimani njëkohësisht të jetë musliman dhe politeist ose musliman dhe komunist. Në Islam nuk ka vend për ate që dëshiron të jetë lojal dhe nacionalist i vërtetë. Kjo është çështje e identitetit, me ç'rast njëra tjetrën e përjashton.

Nacionalizmi nuk mund të jetë në pajtim me Islamit, sepse këto dy shkolla kanë ideologji të kundërta. Që të dyja paraqesin dy pole plotësisht të kundërta në frymën e tyre, në esencën, në drejtimin dhe synimin e tyre.

Siç do të shpjegojmë edhe më vonë, Kur'ani në mënyrë të qartë i ka flakur bazat e nacionalizmit, dhe thekson se gjuha, ngjyra apo raca nuk janë kritere për bashkim dhe privilegje. Kritere të vetme janë besimi dhe virtyti. Ideologjia e përbashkët është e bazuar në unitetin e Ummetit Islamik, e jo në atë të racës, të atdheut, të gjuhës apo madje edhe të kulturës. Qëllimi i nacionalizmit është që të krijojë një unitet kombëtar, kurse synimi i Islamit është uniteti universal. Gjërat më të rëndësishme për nacionalizmin janë lojaliteti dhe dashuria për atdheun, kurse për Islamit këto janë Zoti dhe feja. Nacionalizmi e thekson autenticitetin e kufijve gjeografikë dhe dallimeve racore, kurse Islami të gjitha këto i mohon. Nacionalizmi anon kah kufizimi dhe raca, ndërsa Islami e pranon si të vërtetë vetëm pikëpamjen universale.

Nacionalizmi i çmon vetëm traditat historike, kulturën, qytetërimin, idetë dhe fytyrat historike të popullit të vet, ndërkaq vizioni i Islamit i shlyen kufijtë, racat, fiset dhe popujt. Musa a.s., Isa a.s., Muhammedi a.s., i përkasin mbarë njerëzimit. Islami dëshiron që popujt ta konsiderojnë Kur'anin si Libër të tyre, Qaben si Kible kurse liderët e vërtetë të Islamit t'i shohin si liderë të vetë.

Nacionalizmi e ka shumë vështirë që ta pranojë këtë pikëpamje. Sipas vizioneve të tij të kufizuara, hyrjen në Islam ai e konsideron si shkelje të ligjit apo si diçka krejtësisht të rrezikshme. Ai kombin ia bashkangjet Kirit dhe Darit, e jo Muhammedit a.s. dhe Aliut. Nacionalizmi synon ta ringjallë të kaluarën e lashtë, të cilën Islami e quan paganizëm. Islami faraonin e mallkon, por nacionalizmi egjiptian atë e bën hero kombëtar, i cili duhet të adhurohet.

Si rezultat i logjikshëm i këtij qëndrimi është ngjallja e besimeve kombëtare. Andaj aspak nuk duhet befasuar nga fakti se regjimi nacionalist i Pahlavit i ka inkurajuar besimet e zoroastrianizmit e të bahaizmit, të cilët konsideroheshin si besime të iranianëve. Gjatë sundimit të Hitlerit në Gjermani, mendimtarët nazistë ishin ithtarë të këtyre dy grupeve: njëri grup konsideronte se Krishti është pasardhës i një hebreu palestinez, andaj krishterimi duhej edhe të flakët, kurse grupi tjetër i kthyer kah krishterimi dëshironte të dëshmojë se Krishti nuk ishte palestinez, por i takonte racës nordike.

Islami thotë se të gjithë muslimanët e botës janë pjesë e një trupi, dhe se të gjithë popujt islamë, arabët, joarabët, turqit, afganët, indianët, zezakët, të bardhët dhe popujt e racës së verdhë, duhet që për nga besimi i tyre t'i përkasin vetëm një ummetit. Mirëpo, solidaritetin religjioz të një vendi me popujt tjerë, nacionalizmi e konsideron si të rrezikshëm për identitetin fisnor dhe kombëtar.

Kësisoj, vizioni i nacionalizmit mbi shoqërinë dhe politikën është plotësisht i kundërt me atë të Islamit, andaj këta të dy asnjëherë nuk mund të shkojnë bashkë. Për këtë shkak ndonëse nationalistët e vendeve tjera islame kërkojnë heshturazi ndarje nga Islami si kusht që nacionalizmi i tyre të ketë sukses, me veprimet e tyre ata e zbulojnë urrejtjen që e kanë për ata të cilët e kërkojnë Islamin.

2. Lufta e të Dërguarit a.s. me nacionalizmin kurejsh

Në kohën e paraqitjes së Islamit dhe të Revolucionit Islamik, fiset ishin organizatat e vetme sociale dhe politike të arabëve paraislamike, ndërsa raca dhe gjuha e tyre shërbente si njësi matëse për superioritetin apo inferioritetin. Bazë e unitetit ishin gjaku dhe lidhjet fisnore, pra format më të vrazhda të nacionalizmit dhe racizmit. Gjithashtu edhe gjuha konsiderohej si shenjë e superioritetit, dhe mu për këtë arsye, arabët i quanin pjesëtarët e popujve joarabë me emrin "exhm", që don të thotë memec.

Përparimi i Revolucionit Islamik i flaku mënjanë idetë e këtilla dhe organizimet fisnore; me parullën e stuhishme "Nuk ka zot tjetër pos All-llahut". Ai shkaktoi që bindja dhe ideologjia ta mbizotërojnë dashurinë për gjakun, gjuhën apo për territorin.

I Dërguari, s.a.v. i cili themeloi një shoqëri islame universale dhe pa klasa, me një fjalë i bashkoi popujt e ndryshëm dhe i mënjanoi dallimet e tyre fisnore. Me rastin kur i Dërguari tuboi tre muslimanë nga tre vende të ndryshme, respektivisht Selmanin nga Persia, Suhejbin nga romakët e bardhë dhe Bilalin nga Etiopia, një arab i quajtur me emrin Kajs-bin-Mutateba, hyri brenda dhe këta që i

përmendëm më sipër i emërtoi si "të huaj." I zemëruar shumë, i Dërguari tha: "Edhe yt atë është i njëjtë, edhe feja yte është e njëjta, ndërkaq arabizmi, për të cilin me sa po shihet po krenohesh aq shumë, nuk i takon as babait tënd e as nënës sate (duke menduar se Ademi dhe Hava janë prindët e të gjithë juve)". Pastaj deklaroi "Ai që e propagon besimin e solidaritetit fisnor, që lufton për të dhe është i gatshëm të japë jetën për të, ai nuk është me ne."

Forcat nacionaliste dhe paragjykimet fisnore me kokëfortësi të madhe qëndruan kundër këtij mesazhi revolucionar të Islamit dhe shërbyen si barrierë kundër përhapjes së tij. Këta faktorë shkaktuan që kurejshitet dhe popujt tjerë të asaj kohe të qëndrojnë kundër të Dërguarit të Islamit. Ata protestuan kundër asaj se Kur'ani nuk zbriti te ndonjë njeri i zgjedhur nga Meka apo Taifi. Lidhur me këtë, Kur'ani thotë:

"Dhe ata thonë: Përse ky Kur'an nuk u shpall nga ndonjë njeri i rëndësishëm në të dy qytetet?"

Fiset arabe, me vizionet e tyre fisnore të kufizuara, habiteshin se përse i Dërguari nuk i takonte fisit të tyre, dhe se mos vallë synonte që ta mäkëmbë superioritetin e fisit të tij. Ebu Xhehli tha haptas: "Ne jemi të barabartë me familjen e Abdulmenafit. Në kalorësi jemi rivalë, kurse për nga zemërgjerësia jemi të njëjtë. Si është e mundur që tani ata të proklamojnë profeci dhe shpallje? Pasha Zotin, ne nuk do ta pranojmë Muhammedin si të Dërguar."

Paragjykime të njëjta racore dhe fisnore kishin edhe hebrenjtë, të cilët qëndruan kundër Muhammedit, ndonëse një kohë të gjatë pritnin që të paraqitet një i dërguar i tillë. Kështu ata refuzuan ta pranojnë të vërtetën dhe ishin të brengosur sepse i Dërguari ishte pasardhës i Ismailit, e jo i israelitëve. Në këtë mënyrë, ata i bashkuan paganët dhe politeistët dhe i drejtuan kundër besimtarëve të Zotit.

Ndezja e zjarrit të ndjenjave nacionale ishte arma më e dobët e hipokritëve medinas kundër Islamit. Me një rast, njëri nga liderët e tyre, duke e aktualizuar çështjen e Betejës së Beghathit, arriti që

të shkaktojë konflikt në mes dy fiseve të mëdha muslimane - atij të Eusëve dhe të Hazrexhëve, kur përnjëherë zbriti ajeti vijues:

"O ju që besuat, në qoftë se ju i bindeni një grupi të atyre që iu është dhënë libri, ata, pas besimit tuaj, do t'ju kthejnë në mosbesimtarë."
(3:100)

Lideri i hipokritëve medinas, Abdull-llah bin Ubej, ishte një nationalist lojal që njerëzit e Medinës vazhdimisht i nxitte në favor të nacionalizmit, duke u thënë:

"Nga viset tjera, në vendin tuaj kanë ardhur disa lypës që tani janë bërë qafëtrashë. Ata janë si qentë që janë majmur për të na sulmuar neve."

Ai u thoshte medinasve:

"Ju gabuat shumë që lejuat që këta të huajt t'i bëni partnerë në të mirat tuaja dhe në vendin tuaj. Po qe se prej sot më nuk i ndihmoni, ata menjëherë do të largohen."

Ajeti vijues u shpall si përgjigje për këto fjalë të kota:

"Ata janë që u thanë (vendasve të Medinës): Mos u jepni atyre që janë me të Dërguarin e All-llahut (muhaxhirëve), ashtu që të shpërndahen!. Po, të All-llahut janë pasuritë (depot) e qiejve e të tokës, por hipokritët nuk janë duke kuptuar."
Ata thonë: "Nëse do të kthehemi (prej luftës me beni Mustalikët) në Medine, ai më i forti patjetër prej aty ka për ta përzënë atë më të dobët!"

(ashtu thonë) Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por hipokritët këtë nuk e dinë." (63:7-8)

Pra, shihet mirë dimensionin e rrezikshëm të kundërshtimit të Islamit, që mbështetjen e vet e gjente në ndjenjat fisnore dhe nacionale. Tani është më se e qartë se, me gjithë atë që u tha më parë se përveç paganizmit dhe politeizmit, armiqtë më të mëdhej të Islamit janë edhe paragjykimet e gjakut, të vendit, të paraardhësve dhe të fisit. I Dërguar luftoi shumë ashpër kundër tërë këtyre, dhe me këtë bëri që të mënjanohen barrierat që qëndronin përpara ideologjisë hyjnore të Islamit.

Adhurimi i fisit (tribalizmi) dhe ndjenjat tribaliste çdoherë kanë paraqitur kërcënim për Islamin. Nationalisti arab mburret me atë që është arab, e jo musliman. Egjiptiani mendon për faraonin e tij. Turku mundohet ta tregojë lidhjen e tij me Xhingisin dhe Hulagun. Iranian krenohet me Kirin, Darin, Buzarjomehrin, Manin dhe Mazdakun, në vend që të krenohet me Muhammedin s.a.v. dhe Alinë. Figurat mitologjike të hindusëve, indiani i konsideron si heronj, dhe në vend që të shkojë te burimi i Zemzemit, ai nisat kah lumi Gang. Në këtë mënyrë rrezikohet entiteti i Islamit. Mu për këto, Islami çdoherë ka qenë armik i nacionalizmit.

Ndërkaq, Islami i drejtohet gjithë njerëzimit si një bashkësi të vetme. Sistemi i tij nuk është vetëm për një komb, për një racë apo për një regjion të posaçëm, por për tërë shoqërinë njerëzore. Ata të cilët e kanë pranuar këtë sistem konsiderohen të barabartë dhe vëllezër, dhe kanë të drejta dhe detyra Bazat e nacionalizmit nga pikëpamja e Kur'anit dhe Sunnetit

1. Uniteti i njerëzimit apo uniteti racor dhe kombëtar?



Nacionalizmi bazohet në autenticitetin e uniteteve racore dhe kombëtare. Ai e ndan shoqërinë njerëzore në bashkësi të kufizuara e të pavarura, dhe këtë e bën sipas kufijve gjeografikë, faktorëve të racës, të gjuhës, të historisë, me organizime politike e tjerë, ndërsa të gjithë që gjenden jashtë bashkësive i quan si të huaj dhe shpeshherë i nxit armiqësitë mes tyre. Nacionalizmi nuk i drejtohet tërë njerëzimit, por ai kufizohet vetëm brenda bashkësive kombëtare kurse si synim të vetin e ka themelimin e shtetit kombëtar, e jo të shoqërisë universale.

Ndërkaq, Islami i drejtohet gjithë njerëzimit si një bashkësi të vetme. Sistemi i tij nuk është vetëm për një komb, për një racë apo për një regjion të posaçëm, por për tërë shoqërinë njerëzore. Ata të cilët e kanë pranuar këtë sistem konsiderohen të barabartë dhe vëllezër, dhe kanë të drejta dhe detyra të njëjta në përkushtime, politikë, ekonomi dhe në jetën shoqërore. Qëllimi përfundimtar i Islamit është themelimi i një shoqërie universale monotiste, e cila nuk do t'i përfillë kufijtë gjeografikë, racorë, gjuhësorë apo kulturorë, dhe të gjithë t'i bashkojë në një bashkësi të vetme. Islami e gjykon ndarjen e njerëzimit në bashkësi racore dhe nacionale, të cilat bëhen në bazë të gjakut apo të territorit, si dhe nuk e jep pëlqimin për autenticitetin

e dallimeve racore dhe nacionale. Sprovat e vetme të tij për individin janë nderi, besimi, bindja dhe veprat e mira.

Nacionalisti e kufizon vizionin e vet për interesat nacionale dhe beson në kufizimin e të tjerëve. Ai njeri ka dy kritere, një për vete dhe për bashkatdhetarët e tij, ndërsa tjetrin për të huajt; dy forma gjithashtu merr edhe sjellja e tij. Atyre që janë jashtë kombit të tij, ai nuk ua jep të drejtën për të përfituar nga privilegjet e njëjta.

Mirëpo, Islami mesazhin e vet ia jep tërë njerëzimit dhe të gjithë i gjykon objektivisht, pa marrë parasysh qëndrimet shkurtpamëse fisnore të nacionalistëve. Misioni i tij nuk është i trajtës kombëtare, por ai është universal, dhe synon që t'i lirojë të gjitha marrëdhëniet në mes qenieve njerëzore, pasi që të gjitha relacionet kulturore dhe shpirtërore varen nga vetë paraqitja e Islamit dhe nga shpallja e mesazhit hyjnor të tij. Ai e dëshiron përsosurinë e gjithë njerëzimit dhe e hudh poshtë vetëpëlqimin dhe egocentrizmin fisnor. Nacionalizmi e inkurajon njeriun që t'i shërbejë vetëm interesave të shoqërisë së tij dhe të synojë kah kërkimi dhe madhështia e interesave të veta, madje edhe po qe nevoja që të kufizohen interesat dhe të drejtat e popujve tjerë. Mirëpo, Islami e mëson individin që të mendojë për tërë njerëzimin dhe të mësohet që për të ta sakrifikojë edhe veten apo të heqë dorë nga interesat e grupit.

Kur'ani e thekson unitetin universal të njerëzimit:

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra". (4:1)

Kjo do të thotë se dallimet në vendlindjen, atdheun dhe në edukatën nuk ndikojnë në esencën dhe nuk mund ta zëvendësojnë bashkësinë universale me bashkësi të kufizuara:

"Ai është që ju krijoi (filloi) prej një njeriu; aty (mbi tokë) jetoni (qëndroni) dhe nën te do të pushoni". (6:98)

Dallimet në racë, fis, komb dhe familje nuk kanë autenticitet legjitim dhe nuk janë bazë e unitetit apo kriter për superioritetin dhe inferioritetin. Ato janë vetëm kuptime të lehtësimit të marrëdhënieve njerëzore:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat) e All-llahu është shumë i dishëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." (49:13)

Kësisoj, ndarja në fise dhe grupe është bërë me qëllim që njëri me tjetrin të njihen më mirë, jo për t'u mburrur, për të shfaqur dashuri apo urrejtje, për të kërkuar superioritet ose për të shkaktuar kundërshtime. Kriteret e vetme janë besimi, bindja dhe nderi. Ndarjen e njerëzimit në bashkësi politike dhe kombëtare, Kur'ani e konsideron si krim të njerëzimit dhe fton për dënim hyjnor:

"Thuaj: Ai ka fuqi (t'ju shpëtojë, por edhe) t'ju sjellë dënimin prej së larti ose prej së poshti nën këmbët tuaja apo t'ju ndajë në grupe e ta luftoni njëri-tjetrin." (6:65)

Ndarjen e njerëzimit dhe pretendimin për superioritet në baza të gjakut dhe të vendit, Kur'ani e gjykon ashtu siç e gjykon krimin e faraonit:

"Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e ka grupëzuar..." (28:4)

Në Kur'an nuk ka asnjë ajet të vetëm që do të kishte të bëjë me autenticitetin e kombësisë dhe ndarjen e njerëzimit në baza të gjakut e të vendit. Kur'ani i fton të gjithë njerëzit drejt mirësisë dhe lumturisë, e jo drejt privilegjeve racore apo nacionale.

I Dërguari s.a.v. gjithmonë e ka përsëritur thënien se qeniet njerëzore formojnë një Ummet të vetëm, dhe se superioriteti territorial apo racor nuk mund të jetë autentik. Ai thotë:

"Nuk ka superioritet të arabëve ndaj popujve joarabë apo anasjelltas, të popujve joarabë ndaj arabëve. Të gjithë janë djem të Ademit."

Ose për atë se i tërë njerëzimi është një bashkësi dhe se kriteri i vetëm është feja dhe nderi:

"Nuk mund të ketë superioritet të njërit mbi tjetrin, përveç kur janë në pyetje nderi dhe feja. Të gjithë njerëzit janë djem të Ademit, ndërsa Ademi është prej dheut.

Një hadith tjetër i të Dërguarit s.a.v. thotë:

"Nuk mund të ketë superioritet të arabëve kundrejt joarabëve, të joarabëve ndaj arabëve, për të bardhët ndaj zezakëve dhe për zezakët ndaj të bardhëve, përpos kur është dëlirësia (takvaja) në pyetje".

Pas pushtimit të Mekës, në fjalimin e tij të parë publik i cili në të vërtetë paraqitte deklaratën e vizioneve ideologjike dhe politike të tij, duke iu drejtuar Kurejshitëve, i Dërguari s.a.v. tha: "O njerëz, të gjithë ju jeni prej Ademit, kurse Ademi është prej dheut. Nuk mund të ketë mburrje për prejardhjen familjare, nuk mund të mburren arabët kundrejt joarabëve apo joarabët ndaj arabëve. Vlerën tuaj Zoti e çmon varësisht nga dëlirësia juaj."

Kështu, i Dërguari qartë deklaroi se marrëdhëniet fisnore nuk mund të jenë arsye për mburrje apo për superioritet. Kriteret e vetme janë besimi, si dhe sjellja e mirë dhe e drejtë. I Dërguari gjithmonë e ka theksuar unitetin e njerëzve dhe e ka gjykuar ndarjen e tyre në bashkësi të kufizuara racore dhe nacionale. Traditat dhe rrëfimet na bëjnë të ditur se në namazet ditore dhe pas shqiptimit të "Shehadetejn" (dy dëshmime V.P. - nuk ka zot tjetër pos All-llahut dhe Muhammedi është i Dërguari i Tij), ai e përsëriste fjalinë: "Dëshmoj se të gjithë shërbëtorët e Zotit janë vëllezër".

Nacionalizmi apo Internacionalizmi?

Agim Abdullahu

Në pajtim me diktatet e Kur'anit, muslimanët duhet të kenë mision universal e jo mision nacional. Islami synon një shoqëri të vetme dhe i hudh poshtë bashkësitë e kufizuara fisnore dhe nacionale, të cilat mendojnë vetëm për interesat e veta.

Ai i fton të gjithë popujt e botës që të bashkohen nën një flamur:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun." (3:110)

"Dhe ashtu (sikur u udhëzuan në fenë Islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e gjykimit) ndaj njerëzve..." (2:143)

Da'veti i të Dërguarit s.a.v. nuk ishte fisnor apo nacional, por ai ishte mision universal:

"Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (34:28)

"O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmuar, lajmëtar përgëzues e qortues. Dhe me urdhërin e All-llahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar ndriçues." (33:45-46)

"Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejtën idhujtarët". (9:33)

Pasi që misioni i të Dërguarit nuk ishte fisnor apo nacional, por ishte mision për tërë njerëzimin, në vitin e gjashtë të shpërnguljes së tij, ai u dërgoi letra Heraklisit, Kosrosit, Mbretit të Iranit, Nexhashiut të Etiopisë dhe Mukaukisit të Egjiptit, duke i ftuar që të kalojnë në Islam.

Besimi dhe mësimet e Kur'anit janë universale dhe i drejtohen tërë njerëzimit:

"E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (21:107)

"Po ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë për botën (e njerëzve e të xhinëve)." (68:52)

"Ai, që ia shpalli Furkanin (Kur'anin, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të vet (Muhammedit) që të bëhet pejgamber i botës (këshillues), është i madhëruar." (25:1)

Tani është më se e qartë se Islami, me qëllimet, misionin dhe me vizionin e tij që e ka, është plotësisht në kundërshtim me nacionalizmin.

2. Cili duhet të jetë fokusi kryesor i besnikërisë: Zoti apo atdheu?

Përderisa nacionalizmi beson se atdheu duhet të jetë fokusi i besnikërisë dhe i lojalitetit, Islami nga ana tjetër beson se ky fokus duhet të jetë Zoti xh.sh. dhe feja e Tij. Kur'ani thotë:

"...vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos All-llahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë." (12:40)

Bazë e nacionalizmit është dashuria e dikujt për atdheun e tij, kurse bazë e Islamit është besimi në Zotin dhe përkushtimi absolut ndaj Tij.

"Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti kërkohmë ndihmë!" (1:4)

Nacionalizmi ka për qëllim që njeriu, pjesën më të madhe të dashurisë dhe lojalitetit t'ia kushtojë atdheut; madje edhe lojalitetin ndaj Zotit xh.sh. t'ia nënshtrojë dashurisë për atdheun. Kjo nga ana e saj është një lloj politeizmi. Lutja i kushtohet vetëm Zotit xh.sh. dhe po që se bëhet edhe për diçka tjetër, atëherë kjo paraqet idhujtari dhe ndjekje të rrugës së djallit:

"A i vure re ata që mendojnë se besuam atë që të zbriti ty, dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë djalli, e duke

qenë se janë urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t'i humbë në pafundësi." (4:60)

Nacionalizmi më tepër rëndësi i jep atdheut sesa që i kushton besimit, fesë dhe Zotit, kurse Islami e bën të kundërtën:

"Pra, ikni e mbështetnu tek All-llahu, unë prej Tij jam një qortues i hapët. E mos i shoqëroni All-llahut edhe ndonjë zot tjetër, edhe për këtë unë jam i dërguar prej Tij që t'ju tërheq haptazi vërejtjen." (51:50-51)

Nacionalizmi beson se ndjenjat nacionaliste janë të vërteta atëherë kur ato nuk trazohen nga faktorë tjerë (shihet se fjala është për Zotin dhe fenë), kurse Islami pohon se e vërteta është plotësisht e kundërt. Me të vërtetë, Islami insiston që monoteisti, bindjen ose besimin e vet ta shfaqë vetëm ndaj Zotit xh.sh.

Është një urdhër i qartë islamik, i cili thotë: "Askush kurrsesi nuk guxon t'i zbatojë urdhërat e njerëzve në qoftë se këto urdhëra janë në kundërshtim me urdhërat e Zotit."

Nëse urdhërat e Zotit bien ndesh me patriotizmin, atëherë dhënia e prioritetit për kombin apo atdheun është në kundërshtim me parimin e Islamit.

Thua: "Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve!" (6:162)

Si nga pikëpamja individuale, ashtu edhe nga ajo shoqërore, çështje më e rëndësishme për nacionalizmin janë interesat nacionale, kurse për Islamit janë dashuria ndaj Zotit dhe urdhësive hyjnore. Dashuria dhe urrejtja, miqësia dhe armiqësia, lufta dhe paqja, të gjitha këto bëhen për hir të Zotit xh.sh. dhe fesë së Tij. Kurrfarë faktori tjetër nuk mund të vijë parasysh.

Në nacionalizëm, sovraniteti i takon kombit ndërsa kritere janë interesat kombëtarë. Mirëpo, në Islam, sovran është vetëm Zoti xh.sh. dhe asnjë faktor tjetër nuk mund të dalë para ligjeve të Tij.

"... vendimi nuk është i tjetërkujt, vetëm i All-llahut,..." (12:67)

"... pra, i tërë sundimi është në duart e All-llahut, të lartit, të madhëruarit." (40:12)

"... Vetëm Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do të ktheheni." (28:88)

"... Vetëm i Tij është sundimi (gjykimi) dhe Ai është më i shpejti i llogaritësve." (6:62)

Kur'ani i gjykon të gjithë ata që autenticitetin ia mvëshin gjërave të tilla siç janë kombi dhe atdheu, në vend që këtë ta bëjnë për urdhëresën vijuese të Zotit:

"A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut." (5:50) Ata përpiqen për sundimin e injorancës (që është antiislamike), por nuk ka gjë më të mirë se gjykimi i Zotit xh.sh.

Në Islam, sovraniteti i takon Zotit dhe fesë së Tij. Kombi vepron si zëvendës i Tij brenda kufijve të kësaj shkolle. Fillimi dhe përfundimi i referimit është Zoti:

"...Çka t'ju jep Pejgamberi, atë merrne e çka t'ju ndalojë, përmbanju dhe kini frikë All-llahun..." (59:7)

"E për këtë shkak (të përçarjes së tyre) ti thirr dhe përqëndrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre..." (42:15)

I Dërguari s.a.v. ka theksuar se lojaliteti dhe dashuria janë vetëm për Zotin xh.sh. dhe për asgjë tjetër. Në këtë mënyrë, ai e godet rëndë nacionalizmin duke thënë:

"Bëje Zotin xh.sh. bosht të dashurisë dhe të lojalitetit tënd dhe asgjë tjetër."

Mirëpo nacionalizmi e adhuron kombin dhe atdheun prandaj edhe bie në konflikt me parimet themelore

të Islamit, respektivisht me monoteizmin dhe hyn në një farë lloji të politeizmit të fshehur.

Islami si kuptim apo si qëllim?

Faik Miftar

Analizimi i ideve dhe i sjelljeve të të ashtuquajturve nacionalistë të devotshëm të cilët flasin si për kombin, ashtu edhe për Islamin, tregon se ideali kryesor i tyre është nacionalizmi ose liberalizmi, ndërsa Islami këtu shërben vetëm për mjegullimin e kuptimeve. Në vend që Islamin apo fenë ta konsiderojnë si një fe që mjafton për vetveten dhe për hir të Zotit, ata e konsiderojnë atë si një kuptim për realizimin e idealeve të tyre patriotike. Sipas tyre, Islami nuk është qëllim por vetëm mjet për të arritur qëllimin, qëndrim ky, i cili në vete paraqet një politeizëm.

Ata mendojnë se në emër të Islamit mund t'i ngjallin edhe ndjenjat nacionaliste, por qëllimi përfundimtar i tyre është pavarësimi, e jo mëkëmbja e rendit islamik. Për këtë shkak ata përpiqen që në emër të Islamit ta inkurajojnë despotizmin dhe kolonizimin, dhe përkrahësit e vërtetë të Islamit i shtypin në mënyrën më të ashpër që mund të ekzistojë.

Sipas urdhëresave të Islamit, qëllimi përfundimtar duhet të jetë Zoti e jo liria, pavarësia apo diçka tjetër. Lirinë dhe pavarësinë do të duhej ta duam për hir të Zotit dhe të Islamit, e jo në ndonjë mënyrë tjetër, e cila do të shpiente në politeizëm. Në qoftë se i studiojmë shkrimet e nacionalistëve që flasin për Islamin, do të vërejmë se Qabeja e tyre është pavarësia, liria, dhe atdheu, ndërsa Zoti xh.sh. dhe Islami janë vetëm mjete për t'i arritur qëllimet e tyre.

Gjithashtu edhe muslimani i vërtetë e do lirinë dhe pavarësinë dhe bën çmos që këto t'i mbrojë, por ai këtë do ta bëjë vetëm për hir të Zotit e të Islamit.

3. Faktori i unitetit: besimi apo kombi

Nacionalizmi beson se koekzistenca është faktor që qëndron pas kombit dhe unitetit të individëve të cilët përfshihen në një grup të veçantë. Rrethanat e përbashkëta natyrore dhe gjeografike, bashkësia apo raca, gjuha, si dhe organizimet e ndryshme historike dhe politike krijojnë lidhje ndërmjet individëve, të cilët jetojnë së bashku përderisa atë e kërkojnë interesat e tyre. Prej këtu fillon dallimi midis tyre dhe të huajve.

Pikëpamja e Islamit është në kundërshtim me këtë, sepse në Islam, lidhjen ndërmjet individëve e bën besimi dhe shkolla që del nga dashuria për të dhe e cila shërben si njësi matëse për përshtatshmërinë. Sipas Islamit, individi, besimi i të cilit shtrihet në polin e kundërt, qoftë ai bashkatdhetar, fqj apo farefis, konsiderohet si i huaj, ndërsa bashkësia e besimit bën që edhe njerëzit me të largët dhe nga viset e ndryshme të botës, të jenë më të afërt me njëri-tjetrin.

Selmani ishte nga Farisi (Irani), mirëpo Muhammedi a.s. i Arabisë dhe i familjes Hashimi, atë e konsideronte si anëtar të shtëpisë së tyre. Bilali nga Etiopia dhe Suhejbi nga Roma u bënë anëtarë të qeverisë islamike të siujdhesës së Arabisë. Por, Ebu-Lehebi, Ebu-Xhehli dhe Ebu-Sufjani, të cilët ishin arabë të pastër, u dëbuan nga pushteti i shoqërisë së re edhe përkundër lidhjeve nacionale, racore dhe fisnore që i kishin, u trajtuan si të huaj.

Pikëpamja islamike për kombësinë tërësisht ndryshon nga ajo nacionaliste. Kombësia e muslimanëve nuk bazohet në unitetin e faktorëve gjeografikë apo të atyre gjuhësorë. Ummeti Islamik

Daily New Quotes

**America needs
to understand Islam,
because this is
the one religion that
erases from its society
the race problem.**



— Malcolm X

Website : <http://www.dailynewquotes.com>

paraqet një bashkësi apo shoqëri që është themeluar nga Zoti xh.sh. dhe i Dërguari i Tij, ndërsa anëtarësimi në të varet nga uniteti i besimit, nga vizioni botëror dhe nga sistemi islamik. Islami hudh poshtë çdo kufizim territorial dhe materialist. Dijetari i madh islamik, Ikbali, thotë:

"Vetëm Zoti është ai, i cili është trupi dhe shpirti i kombit tonë,

Vetëm Zoti është ai, i cili e përcakton shkollën e instrumenteve tona,

Vetëm Zoti është ai, i cili është burimi i sekreteve tona.

Dhe vetëm Ai i bashkon mendimet tona.

Fati i popujve është ngushtë i lidhur me atdheun,

Dhe nga prejardhja familjare varet këndellja e popujve,

Por populli ynë ka themele të tjera,

Dhe ky themel mbështet në besimin tonë."

Ummeti islam varet nga besimi i përbashkët. Turqit, iranianët, arabët dhe muslimanët e Indisë formojnë një Ummet të vetëm, ndërsa ai që nuk merr pjesë në privilegjet islamike është i huaj, madje edhe po qe se ai është prind, djalë, fqj apo bashkëvendës. Këtu janë të vlefshëm vetëm kufijtë e mendimit dhe të besimit, e jo kufijtë konvencionalë që i ka vënë dora e njeriut. Ngjyra, gjaku dhe territori, të cilat paraqesin dukuri natyrore apo marrëveshje midis njerëzve, nuk mund të konsiderohen si kritere. Arabi, iranian dhe indiani janë të barabartë në Islam, përderisa të jenë muslimanë të vërtetë. Në këtë mënyrë krijohet Ummeti i madh Islam. Prej Tangjerit e gjer në Filipine, të gjitha viset formojnë një komb të vetëm. Kongresi universal vjetor i Haxhit është vetëm një shembull i këtij uniteti të besimit musliman.

Shpërngulja e të Dërguarit është simbol i zhvendosjes nga kombësia gjeografike në atë ideologjike. Ikbali thotë:

"Nyjen e ngatërruar të kombësisë muslimane e zgjidhi udhëheqësi ynë i cili u shpërngul nga vendlindja e tij.:

Kur'ani thotë:

"Ne të zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur'anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi All-llahu..." (4:105)

Tekstet islame këtë e theksojnë shumë qartë, meqë, prej kohës së Islamit të hershëm, sjellja e të Dërguarit dhe e Imamëve ishte aq e qartë saqë nuk mbeti vend për kurrfarë dyshimi. Mu këtu mësimi i nacionalizmit ndahet krejtësisht nga ai i Islamit, prandaj nacionalizmi edhe e mohon Islamin sepse është i themeluar në baza tjera.

Kur'ani shumë qartë thekson se baza e unitetit është besimi e jo kombësia:

"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtone nimetin e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër..." (3:102)

"S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër..." (49:10)

"Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua." (21:92)

I Dërguari fliste për ummetin sikur për një trup, pjesëtarët e të cilit jetësisht ishin të lidhur së bashku. Ai tha:

"Muslimanët janë si një trup. Në qoftë se lëndohet syri i një pjese tjetër, atëherë i tërë trupi do të lëndohet".

Pjesëtarët e këtij ummeti i hudhin poshtë kufijtë e tokës e të gjakut dhe adhurojnë vetëm Një të dashur, dhe kështu ata përfitojnë nga të drejtat dhe detyrimet e asaj shoqërie. Prej Afrikës Veriore e deri në Indonezi, prej Egjiptit e deri në Palestinë, Arabi, Iran, Afganistan dhe Pakistan, të gjithë kanë të drejta dhe detyrime të njëjta.

Ata që me anën e nacionalizmit dhe të racizmit, e përçajnë unitetin universal të muslimanëve dhe ndahen nga rruga e besimit, sipas të Dërguarit janë paganë.

I Dërguari shumë qartë është deklaruar se kushdo që ndjek ndonjë faktor tjetër pos Zotit dhe besimit dhe që orvatet për diçka të këtyllë, atëherë ai e ka braktisur Islamin dhe është kthyer kah paganizmi.

Në Islam, baza të një grupi dhe kombi nuk janë gjaku dhe territori, po besimi. Përkitazi me femohuesit, Kur'ani i Shenjtë thotë:

"Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezër në fe..." (9:11)

Ebu-Davudi, në librin e tij "Xhihad", e citon të Dërguarin s.a.v. i cili thotë:

"Zoti më ka urdhëruar që t'i luftoj femohuesit kështu që ata ta pranojnë Njëjësinë e Zotit dhe të kthehen kah Kibla, si dhe të falen dhe të agjërojnë ashtu siç bëjmë edhe ne. Kur një herë ta pranojnë besimin tonë, atëherë ata do t'i kenë të gjitha të drejtat dhe obligimet që i kanë muslimanët tjerë". Feja paraqet kufizim të vërtetë të kombësisë. Bashkëfetari bëhet bashkatdhetar ndërsa jobesimtari bëhet i huaj.

"Muhammedi është i dërguar i All-llahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete..." (48:29)

"Ju e keni shembullin më të mirë te Ibrahimit dhe te ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që

adhuroni, pos All-llahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm All-llahun Një!" (60:4)

Shkolla e nacionalizmit të gjithë i trajton si vëllezër dhe të barabartë, qofshin ata jobesimtarë apo femohues dhe fetarë apo keqbërës. Mirëpo në Islam, personi i cili nuk e ka besimin e njëjtë dhe që nuk ka lidhje me muslimanët, nuk konsiderohet i barabartë, madje nëse ai njeri është edhe "bashkatdhetar",

"O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj,..." (3:117)

Nacionalizmi i konsideron bashkatdhetarë të gjithë njerëzit e një vendi dhe ata që i përkasin ndonjë populli tjetër janë të huaj, ndonëse edhe këta janë muslimanë. Islami beson në të kundërtën:

"O ju që besuat, mos e zini mik armikun tim dhe armikun tuaj..." (60:1)

Të gjitha marrëdhëniet i nënshtrohen besimit, madje edhe ato familjare të djalit, të babait, të gruas dhe të burrit, ndërkaq ata që nuk besojnë janë të huaj, përkundër afërsisë së relacionit të tyre familjar:

"O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë". (9:23)

"O ju që besuat, vërtet, disa nga bashkëshortet tuaja dhe nga fëmijët tuaj janë armiq tuaj,..." (64:14)

"Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe Ditën e gjykimit, e ta dojë atë që kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe ata do t'i shpjerë në xhenete, nëpër

të cilat rrjedhin lumenj. Aty janë përgjithmonë. All-llahu ua ka pëlqyer punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Të tillët janë palë (grup, parti) e All-llahut ta dini pra, se ithtarët e All-llahut janë ata të shpëtuarit." (58:22)

Këto ajete e rrënojnë themelin e nacionalizmit, meqë ai bazohet në kufijtë gjeografikë, racorë apo gjuhësorë, dhe në mënyrë të qartë tregojnë se besimi është baza e qëndrimit të njeriut. Ekziston vetëm një bashkësi e rëndësishme, dhe kjo është bashkësia e Zotit xh.sh.

Ky parim i besimit është gjithashtu i pasqyruar edhe në sistemin juridik të Islamit, ku asnjë jomusliman nuk mund ta pranojë trashëgiminë e muslimanit, madje nëse është edhe djali i vet, mu ashtu siç është shpjeguar edhe në ajetin 54 të sures Ahzab. Edhe në hadithet është theksuar se femohuesi nuk mund ta pranojë trashëgiminë e muslimanit.

Dallimet në besim i çlirojnë lidhjet e martesës, andaj nëse njëri prej bashkëshortëve e lë Islamit apo bëhet femohues, atëherë marrëdhënia e tyre do të jetë jolegjitime. Këtë gjithashtu e urdhëron edhe Kur'ani.

Shoqëria, të cilën në Medinë e themeloi i Dërguari, bazohej në besimin, ndërsa të gjitha dashuritë ndaj territorit, gjakut apo racës, fare u mohuan. Kjo ishte një shoqëri e cila në tërësi i kundërvihet parimit të nacionalizmit.

Në betejat e Bedrit, të Uhudit dhe të Hendekut, i Dërguari luftoi krah për krah me ensarët e Medinës, të cilët konsideroheshin për të huaj. Gjatë këtyre betejave, gjaku dhe territori iu nënrenditën besimit. Hudhejfa e sulmoi të atin; Ebu Bekri e nxori shpatën kundër djalit të vet Abdurrahmanit; Abbas-bin-Abdul-Mutallibi, xhaxhai i të Dërguarit, Akili, kushëriri i tij dhe Ebul-A'si u zunë robër. Umeri madje edhe propozoi që të gjithë të zënit rob, që nuk janë dorëzuar dhe faji i të cilëve është dëshmuar, menjëherë të vriten dhe se çdo musliman personalisht ta vrasë të robëruarin që e ka farefis. Vetë Omeri, gjatë betejës e vrau xhaxhanë e tij. Në

këtë mënyrë shkëputeshin lidhjet e farefisnisë vetëm për hir të besimit.

Gjatë pushtimit të Mekës, i Dërguari u priu ensarëve (që ishin "të huaj") që ta sulmojnë vendlindjen e tij, me ç'rast të huajt vranë shumë kushërinj të tij. Ky ishte rast i pashembullt në Arabi që të huajt të bëhen miq kurse të afërmit të bëhen të huaj. Në betejën e Beni-el-Mustalak u shkaktua një zënkë ndërmjet një pjesëtari të fisit Beni-Gafar dhe të atij të klanit Beni-Avs. Ky i pari e goditi atë të dytin me shuplakë. I dyti ishte pjesëtar i ensarëve nga Medina ndërsa i pari ishte emigrant nga Meka. Njëri i ftoi që ensarët t'i ndihmojnë kurse tjetri i ftoi emigrantët. Të dy palët ishin të gatshme për t'u përleshur dhe i nxorën shpatat, por i Dërguari ndërhyri dhe u tha: "Të mjerët ju që ngriteni kundër njëri-tjetrit vetëm për hir të farefisnisë pagane"

Në këtë betejë merrte pjesë edhe nacionalisti i njohur nga Medina dhe lideri i hipokritëve, Abdullah-bin-Ubej. Kur dëgjoji për incidentin që ndodhi, ai filloi t'i nxisë ensarët e Medinës duke u thënë:

"Ne i ftuam këta të huaj që të vijnë në tokën tonë, dhe tani kur u bënë të fuqishëm, ata na sulmojnë edhe neve. Ata janë si qentë që i ushqeni e që pastaj ju sulmojnë. Pasha Zotin, kur të kthehem në Medinë, ata të ndershmit (mendon për medinasit) do t'i dëbojnë të pandershmit (të Dërguarin edhe emigrantët e tij)."

Pastaj u kthye kah bashkatdhetarët e tij dhe tha:

"Sa budallenj që ishit kur lejuat që me këta ta ndani pasurinë dhe pronën tuaj. Pasha Zotin, po i latë vetë, ata nuk do të mund të qëndrojnë."

Kur fjalët e këtij nacionalisti medinas arritën gjer ke i Dërguari, ai e thirri të birin e Abdullah-ut dhe i tha: "Kam dëgjuar se yt atë i ka thënë këto fjalë". Ndonëse shumë e deshte të atin dhe mburrej me të, i biri ia kthen pa ngurrim: "O i Dërguari i Zotit, nëse më lejon, unë do t'ia pres kokën atij dhe do ta sjell atë para këmbëve tuaja". Mirëpo, i Dërguari nuk e lejoi që ta bëjë këtë.

Ndërsa kur luftëtarët muslimanë u kthyen në Medinë, Ibën Abdull-llahu qëndroi para portës së qytetit, e nxori shpatën dhe i klithi të atit: "Ti s'mund të hysh në Medinë (në shtëpinë e vet) nëse i Dërguari këtë nuk ta lejon. Tani do të shohim se në ç'mënyrë, të ndershmit i dëbojnë të pandershmit."

Kjo është baza e ummetit islam dhe kështu formohet bashkësia e besimtarëve të vërtetë, në të cilën marrëdhëniet farefisnore nuk janë asgjë në krahasim me besimin.

Kur Benu-Kajnuka' nga fisi hebraik i Medinës, i revoltuar u ngrit kundër muslimanëve, ata këtë e zunë dhe i Dërguari e dërgoi Ubade-Ibën-Samitin që ta gjykojë. Ai ishte nga fisi Hazreth dhe pa kurrfarë hamendje vendosi që Beni Kajnuka' të dëbohet nga Medina.

Pas tradhtisë së Beni-Kurejdha, të cilët ishin aleatë të fisit të Evsëve, i Dërguari, në cilësinë e gjykatësit e dërgoi Sa'd-bin Muazin, një gjeneral nga Evisi. Për tradhtinë e madhe që e bënë, ai i dënoi me vdekje të gjithë meshkujt e fisit Beni-Garize.

Këta shembuj tregojnë se në shoqërinë islame, rëndësi kanë vetëm besimi dhe mësimi. Nacionalizmi dhe Islami nuk mund të ekzistojnë në të njëjtën shoqëri, ndërsa theksimi i vetëm njërit prej tyre njëkohësisht e nënkupton mohimin e tjetrit.



4. Lidhshmëria me territorin nga pikëpamja e Islamit

Jonus Besimi

Në nacionalizëm, autenticiteti shtrihet në vendin dhe atdheun, kurse në Islam ai mbështetet në krijuesin e tokës e të atdheut. Fjala "natio" në latinishte do të thotë vendlindje. Nacionalizmi e fiton formën e tij nga koekzistenca e një grupi të posaçëm në një vend të veçantë. Ajo tokë i takon vetëm atij grupi dhe asnjë grup tjetër nuk ka të drejtë që të pretendojë në të, kurse të gjithë individët që rrojnë aty, duhet që atë vend ta mbrojnë, madje edhe nëse e flijojnë edhe jetën e tyre.

Mirëpo, në Islam, territori nuk i takon asnjë grupi por vetëm Zotit, ndërsa të gjitha qeniet njerëzore janë vetëm zëvendës. Të drejtën më të madhe për të pretenduar dhe udhëhequr në tokë e kanë vetëm ata që i kryejnë obligimet e tyre ndaj Tij. Kufijtë nuk janë kufij gjeografikë por ata janë kufij të besimit.

Kur'ani këtë çështje e thekson nëpër ajete të ndryshme, dhe thotë se asnjë popull nuk ka monopol mbi asnjë territor, dhe se e tërë bota i takon vetëm Zotit:

"Thuaj: "O All-llah, Sundues i çdo sendi..." (3:26)

"Thuaj: "E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse jeni që e dini?" Ata do të thonë: "E All-llahut". Atëherë Thuaju: "Përse pra nuk mendoni?" (23:84-85)

"Thuaj: "Në dorën e kujt është i tërë pushteti i çdo sendi, dhe Ai është që mbron (kë të do), e që prej Atij nuk mund të ketë të mbrojtur; nëse jeni që e dini?" Ata do të thonë: "Në dorë të All-llahut!" Thuaj: "E si mashtroheni pra?" (23:88-89)

"Thuaj: "Unë jam vetëm këshillues, e nuk ka ndonjë zot tjetër përpos All-llahut Një,

Dërrmuesit. Zot i qiejve e i tokës dhe ç'ka mes tyre, i Plotfuqishmi, Mëkatfalësi." (38:65-66)

Meqë Ai është Zoti i tërë botës, Ai e ka bërë njeriun zëvendës të Tij; prandaj bota i takon të gjitha qenieve njerëzore, e veçanërisht besimtarëve:

"Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë..." (6:165)

"... Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!..." (2:30)

"A nuk e sheh se All-llahu nënshtroi çdo gjë që gjendet në tokë, për të mirën tuaj?..." (22:65)

Pra, të gjitha begatitë e tokës u takojnë të gjithë njerëzve e jo vetëm një grupi apo populli të veçantë.

Kufijtë gjeografikë nuk duhet t'i kufizojnë qeniet njerëzore, meqë bota i takon Zotit dhe njeriut si zëvendës i Tij:

"Melektë që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetes ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (melektë) Ju thanë: "A nuk ishte e gjerë toka e All-llahut e të migronit në të...?: (4:97)

Çdo qenie njerëzore e ka të drejtën që të përfitojë nga begatitë e pjesëve të ndryshme varësisht nga nevojat e saj:

"Kush shpërngulet për hir të (fesë së) All-llahut, ai gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë..." (4:100)

E tërë bota u takon ithtarëve të ideologjisë hyjnore dhe shërbëtorëve të mirë të Tij:

"... me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e Mi të mirë." (21:105)

"Atyre nga mesi i juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë..." (24:55)

Kjo pikëpamje hyjnore e Islamit i mundëson muslimanit të vërtetë që mos të mendojë në drejtimin e lidhshmërisë me kombin apo territorin, por botën ta konsiderojë të atillë se ajo i përket Zotit dhe shërbëtorëve të Tij.

Dijetari Iqball thotë: "Çdo vend që i takon Zotit është edhe i yni",

Kur'ani tërë kohën flet për tërë botën, e jo për arabët apo joarabët, për Mekën apo për Medinën. Po qe se muslimanët do të lidheshin vetëm për një vend të caktuar, atëherë kjo do të duhej të jetë Meka. Por madje, edhe për këtë qytet të shenjtë, Kur'ani flet kështu:

"... Ne e bëmë të barabartë për njerëz, qofshin vendas ose të ardhur..." (22:25)

Rrjedhimisht, shumë juristë Mekën e konsiderojnë si vend i të gjithë muslimanëve, andaj kërkesa e dikujt për pronësi private mbi këtë qytet është krejtësisht e papranueshme. Historia rrëfen se Umeri madje nuk i ka lejuar mekasit që t'i mbyllin edhe dyert e shtëpive, kështu që cilido haxhi të mundej të hyjë brenda kur të dojë vetë. Umer Bin Abdulazizi rreptësisht ndaloi që të merret qira nga haxhilerët, meqë vendi u takonte të gjithë muslimanëve. Shpjeguesit tjerë juridikë nuk kanë shkuar aq larg sa i përket kësaj pikëpamjeje, dhe kanë thënë se njeriu, i cili në Mekë ka ndërtuar shtëpi me ndihmën e kapitalit të vet, ka të drejtë që për ndërtesën e ndërtuar të kërkojë qira, por kjo nuk vlen për oborrin i cili u takon të gjithëve.

Është shkruar se i Dërguari ka thënë:

"Ndalohet shitja dhe dhënia me qira e shtëpive të Mekës"

Nga njëra anë, i Dërguari e shndërroi Mekën në pronë të të gjithë muslimanëve, kurse nga ana tjetër, mosbesimtarët dhe madje edhe banorët e saj i konsideronte si të huaj, dhe kërkoi që të dëbohen prej aty. Lidhur me të pafetë, Kur'ani thotë:

"O ju që besuat, vërtetë idhujtarët janë të ndyrë, andaj pas këtij viti të mos i afrohen më xhamisë së shenjtë..." (9:28)

Kjo është pra ajo pikëpamje e Islamit që e hudh poshtë idenë se përkatësia qytetare varet nga vendlindja. Islami pohon se ajo varet nga besimi dhe me këtë pohim e shkatërron bazën e nacionalizmit.

Emigrimi, simbol i zëvendësimit të territorit me anën e besimit

Për dallim nga nacionalizmi, Islami e mëson njeriun që mos të jepet pas vendit por pas besimit, dhe po qe se paraqitet nevoja, për hir të tij ta lëshojë edhe shtëpinë, vendin dhe atdheun. Migrimi është parimi themelor i Islamit.

Migrimi paraqet ekuivalentin e xhihadit. Lëshimi i shtëpisë dhe i atdheut bëhet për hir të besimit dhe ideologjisë. Shumë të dërguar kanë migruar, ndërkaq edhe shpërngulja e të Dërguarit Muhammed s.a.v. paraqet fillimin e kalendarit dhe të historisë islame.

Në Islam, për dallim nga nacionalizmi, njeriu e braktis atdheun vetëm për hir të besimit, kështu që migrimi nuk është vetëm obligim, por aq më tepër, refuzimi për të migruar për hir të besimit paraqet tradhti, të cilën individit e bën ndaj shoqërisë. Lidhja e dikujt vetëm për një vend të posaçëm dhe kufizimi i veprimtarisë dhe lojalitetit vetëm brenda atij vendi, në Islam paraqet jetë dhe punë të kotë, sepse me këtë rast kanoset rreziku për fenë dhe ideologjinë e atij njeriu. Sjellja e këtillë është antiislamike dhe dënohet:

"Melektë që ua morën shpirtin atyre që ishin mizorë të vetvetes ju thanë: "Në çka ishit ju?" - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (melektë) Ju thanë: "A nuk ishte e gjerë toka e All-llahut e të migronit në të?" (e të praktikoniit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehenemi dhe sa vend i keq është ai! (4:97)

Shprehja "A nuk ishte e gjerë toka e All-llahut" tregon se kufijtë nacionalë nuk kanë kurrfarë vlere dhe se, për promovimin e synimeve islamike dhe për kursin zhvillimor të tyre, muslimanët nuk duhet të lidhen me to:

"Është e vërtetë se ata që besuan, u shpërngulën dhe luftuan me pasurinë e shpirtin e tyre në rrugën e All-llahut..." (8:72)

Migrimi për hir të Zotit si dhe braktisja e vatrës dhe e atdheut vetëm për hir të besimit janë ekuivalente me xhihadin dhe me vetëflijimin.

"Ata të cilët besuan, ata që u shpërngulën dhe luftuan në rrugën e All-llahut, ata meritojnë të shpresojnë në mëshirën e Tij. All-llahu falë shumë dhe është mëshirues." (2:218)

"Ata të cilët besuan, migruan dhe luftuan me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e All-llahut, ata kanë pozitë më të lartë te All-llahu dhe vetëm ata janë fatlumë. (9:20)

"Kush shpërngulet për hir të (fesë së) All-llahut, ai gjen mundësi të madhe dhe begati në tokë. E kush del prej shtëpisë si migrues te All-llahu dhe te i dërguari i Tij, dhe e zë vdekja (në rrugë), te All-llahu është shpërblimi i tij. All-llahu është mëshirues, mbulon të metat." (4:100)

"... ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i vejë në xhenete në të cilat burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e All-llahut, se më i miri shpërblim është tek All-llahu." (3:195)

Vlerën e lartë të migrimit, Islami e nënkupton me theksimin e mohimit të vendit dhe të dashurisë ndaj fesë, gjë që është në kundërshtim të plotë me nacionalizmin.


Sjelljet dhe migrimet e të dërguarve janë gjithashtu edhe një dëshmi për thënien e mëparshme se besimi (e jo vendi) është boshti i Islamit. Pas pushtimit të

Mekës, ensarët me padurim pritnin që i Dërguari të vendoset në Mekë. Mirëpo, ky i thirri ata dhe u tha:

"Unë nuk jam i lidhur për vendin. Unë jam rob i Zotit dhe i dërguar i Tij. Unë erdha tek ju vetëm për hir të Tij, dhe prandaj jeta dhe vdekja ime janë vetëm për ju."

Ndonëse problemi për të cilin ai u shpërngul tanimë ishte zgjidhur, i Dërguari pas pushtimit të Mekës e lëshoi atë dhe u kthye në Medinë, që dëshmon se kurrsesi nuk është i lidhur për vendin apo shtëpinë.

5. Lidhshmëria me gjakun dhe racën nga pikëpamja e Islamit



Nacionalizmi i jep rëndësi të madhe fafëfisnisë, gjë që mund të shpjerë gjer në racizëm. Nacionalizmi shërbehet me trashëgiminë racore dhe historike atëherë kur dëshiron t'i theksojë dallimet apo ngjashmëritë të cilat ekzistojnë në mes dy popujve, dhe këtë e bën që ta vlerësojë pajtueshmërinë apo papajtueshmërinë midis tyre. Disa herë flet për gjakun si bazë e unitetit. Gjithmonë dhe gjithkund paraqiten racizma ekstremë apo gjysmekstremë. Mu ashtu sikundër grekët që i quanin të tjerët barbarë apo hebrenjtë e lashtë që të tjerët i quanin të huaj, apo nacionalistët ekstremë gjermanë dhe italianë, të cilët deshën t'i shfarosin hebrenjtë si dhe

nacionalizmi amerikan i cili akoma shkakton vuajtjen e zezakëve.

Mirëpo, Islami ngritet kundër të gjitha këtyre llojeve të nacionalizmit dhe i kundërvihet kombësisë racore apo asaj historike. Ai thotë se burri dhe gruaja, zezaku dhe i bardhi, i qytetëruari dhe i paqytetëruari, afrikani dhe evropiani, ariani dhe semiti, të gjithë këta kanë rrënjë të njëjta dhe janë krijuar nga prindër të njëjtë; marrëdhënia e gjakut nuk mund të jetë kriter për superioritetin: **"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje..."** (4:1)

I Dërguari thotë:

"Nuk ka superioritet të arabëve ndaj joarabëve, apo të joarabëve ndaj arabëve, sepse të gjithë janë pasardhës të Ademit."

"Askush nuk është superior ndaj tjetrit përveç për nga feja dhe nderi. Të gjithë njerëzit janë pasardhës të Ademit, kurse Ademi u krijua nga dheu."

I Dërguari u drejtohet arabëve me fjalët:

"Binduni dhe jepjani në dorë frerët çdonjërit që nga pikëpamja islamike është më superior dhe ka sjellje të shkëlqyeshme, pa marrë parasysh racën e tij, ngjyrën, vendin dhe territorin, madje edhe nëse ai është etiopian i zi."

"Nuk ka privilegje në marrëdhëniet e ndërsjella, as për arabët kundrejt joarabëve, e as për arabët kundrejt arabëve. Superioriteti mbështetet vetëm në dëlirësinë (takvanë)."

Në Islam, ngjyra e lëkurës nuk është kurrfarë kriteri për superioritetin apo për inferioritetin:

"(Kjo fe jona është) Ngjyrosje e All-llahut, e kush ngjyros (me fe) më mirë se All-llahu. Ne vetëm atë e adhurojmë." (2:138)

I Dërguari thotë:

"Nuk ka superioritet të të bardhit mbi zezakun apo të zezakut mbi të bardhin," përpos nëse kriteri ka të bëjë me virtytin.

Duke iu drejtuar fisit të Beni Hashimit, i Dërguari ka thënë:

"O Beni Hashimë, duani njerëzit për veprat e tyre, e jo për farefisninë."

Lidhur me çrrënjosjen e privilegjeve racore dhe nacionale në Nehxhul Belaga, Imam Aliu thotë:

"I Dërguari i çrrënjosi paragjykimet klasore dhe racore dhe të gjithë muslimanët, pa kurrfarë përjashtimi, i bëri të barabartë para ligjit të shenjtë të Kur'anit."

Përleshja e fortë e Islamit me racizmin mund të kuptohet nga fakti se i Dërguari e emërtoi Usame Ibën Zejdin, një rob etiopian, në postin e komandantit dhe në nivelin e gjeneralëve siç ishin Ubejdull-llah El-Xharrah dhe liderët tjerë kurejshitë dhe ensarë, që do të thotë se hoqi dorë nga kriteri racor apo fisnor. Duke e ditur se farefisnia krijon përçarje, për arsye të ngjashme Kur'ani e dënon faraonin:

"Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kryet lart në tokë, e popullin e saj e ka grupëzuar dhe një grup prej tyre e shtyp, ashtu që djemtë e tyre ua mbyt, e gratë e tyre ua lë të jetojnë. Vërtet, ai ishte prej më shkatërrimtarëve. (28:4)

Kur'ani disa herë e gjykon lidhshmërinë ndaj gjakut dhe e konsideron si barrierë në rrugën e së vërtetës:


"E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): "Pranoni atë që All-llahu e shpalli!" Ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!" Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t'i pasonin)? (2:170)

Menjëherë pas vdekjes së të Dërguarit, paganizmi u bë një rend që filloi të merr hov pas grusht shtetit të emivive, duke shkaktuar kështu inkurajimin e

racizmit kronik dhe të lidhshmërisë me gjakun, mbi themelet e të cilave mbështetet nacionalizmi modern. Mirëpo, shumë njerëz të mësuar dhe ulemaja Sunnitë të rangut të lartë, siç ishin Ebu Bekër Bakilani dhe Imam-ul- Haremejni, këto dy ide i hudhën poshtë dhe nuk i përkrahën. Gjithashtu edhe sektet mu'tezilet dhe havarixhët refuzuan që t'i pranojnë idetë e këtilla.

6. Fanatizmi i injorancës

Fatmir Ameti



Nacionalizmin e shoqëron fanatizmi që të tjerët i konsideron inferiorë dhe i cili mburret vetëm me historinë dhe stërgjyshërit e vet. Kjo ndjenjë ekstreme shkakton që njeriu ta dojë kombin dhe atdheun e tij dhe e dekurajon atë që t'i dojë të tjerët. Njeriu mendon se është i përsosur kurse të tjerët janë të papërsosur dhe të padobishëm.

Islami dhe i Dërguari shumë ashpër e luftuan dhe e dënuan fanatizmin e këtillë.

Duke e shpjeguar fanatizmin, i Dërguari ka thënë: "Fanatizëm nuk paraqet lidhshmëria e thjeshtë me fisin. Fanatizëm paraqet përkrahja e farefisit dhe bashkatdhetarëve, në të mirë e në të keqe, në të drejtë e në të padrejtë dhe në të gjitha rastet. Personi i atillë shkakton zemërimin e Zotit."

Në fjalimin e tij të parë pas pushtimit të Mekës, i Dërguari ka thënë:

"O liderë kurejshitë! Zoti e dënon krenarinë, fanatizmin e injorancës dhe mburrjen me stërgjyshërit, dhe dini se koha e tyre ka përfunduar. Mos harroni se unë sot shkela mbi të gjitha këto kuptime të kryelartësisë."

Fanatizmi i injorancës është ai i cili ka shkaktuar që njerëzit të kërkojnë të dominojnë jashtë egocentrizmit të tyre. Historia e fundit qindvjeçare e

vendeve nacionaliste perëndimore shumë mirë e tregon nacionalizmin e shekullit njëzet. Gjermani bërtet: "Gjermania mbi të gjitha"; ndërsa Musolini deklaroi: "Dashuria për Italinë e paraqet fenë më të lartë." Amerika pohon: "Shtetet e Bashkuara i ka zgjedhur vetë Zoti," ndërsa anglezi beson se "sundimi i botës është e drejtë të cilën britanezëve ua ka dhënë Zoti vetë."

Kur'ani i hudhë poshtë idetë e këtilla. Ai flet për hebrenjtë dhe të krishterët, të cilët kanë kaluar në popuj e jo në grupe religjioze:

"Ata edhe thanë: "Kurrësi nuk ka për të hyrë kush në xhenet, përveç atij që është jahudi ose i krishterë! Ato janë fantazi të tyre! Thuaju: "Sillni argumentin tuaj (çka thoni) po qe se jeni të drejtë? Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten." (2:111-112)

Fanatizmi i injorancës gjithashtu sjell edhe gjer ke mburrja me të kaluarën dhe me stërgjyshërit, andaj i Dërguari këtë e quajti si "gjendje të ndotur."

"Ata që mburren me kombin dhe stërgjyshërit e tyre, duhet ta lënë këtë dhe të përkujtohen se burimet e këtilla të mburrjes nuk janë asgjë tjetër pos qymyr i xhehenemit."

Është shënuar në Kafi se i Dërguari ka thënë:

"Islami ka ngritur duart nga mburrja e paganizmit dhe nga lëvdimi i stërgjyshërve. Të gjithë njerëzit janë nga Ademi i cili është prej dheut, dhe askush nuk ka superioritet mbi tjetërkë, përveç në dëlirësi (takva)".

Njëra ndër vetitë e veçanta të nacionalizmit bashkëkohor është mburrja me historinë e tij, mirëpo Islami këtë e quan paganizëm. Për shembull, nacionalizmi iranian mburret me Sasanidët dhe Achaemenid-ët, kurse Islami këta i quan bajraktarë të paganizmit.

I njëjti fanatizëm i injorancës shkakton që nacionalistët e Egjiptit ta glorifikojnë faraonin të cilin e ka dënuar Zoti, dhe të mburren me të.

7. A mundet individi njëkohësisht të jetë musliman dhe nacionalist?

**ONE UMMAH
ONE BODY
ONE UNITY**

THE BELIEVERS, IN THEIR MUTUAL LOVE, MERCY AND COMPASSION, ARE LIKE ONE BODY: IF ONE ORGAN COMPLAINED, THE REST OF THE BODY DEVELOPS A FEVER. - PROPHET MUHAMMAD (PBUH)

Nacionalizmi dhe Islami janë dy ideologji të kundërta si dhe dy shkolla dhe ide të kundërta, me qëllime dhe programe të pavarura.

Për shkak të natyrës së tij, njeriu mund të ndjekë vetëm një ideologji dhe t'i përmbahet vetëm asaj. Në qoftë se njeriu beson se ai ka dy ideologji, atëherë njëra prej tyre do të jetë aktive dhe e gjallë kurse tjetra pasive dhe e vdekur. Nacionalisti gjerman nuk mund të jetë edhe i krishter i vërtetë, sepse nacionalizmi i tij është i gjallë dhe aktiv, kurse religjioni i tij është pasiv dhe i vdekur. Italiani nuk mundet të jetë njëkohësisht fashist i rryer dhe krishter i vërtetë.

Islami ka një ideologji të posaçme, kurse nacionalizmi ka një tjetër. Qenia njerëzore nuk mundet njëkohësisht të ndjekë dy ideologji të gjalla, përpos në rastin kur ato njëra-tjetrën e pëkrahin dhe e plotësojnë.

Dikujt mund t'i duket gjë e mirë që ta fshehë ideologjinë e tij apo të mos jetë i vetëdijshëm për të, duke mos ditur se a thua dominon patriotizmi i tij apo besimi i tij në fe. Nuk mund të thuhet se ai ka

dy ideologji, meqë njëra prej tyre është aktive dhe e drejton sjelljen e tij. Në qoftë se nga personi, i cili mendon se nuk ka ideologji apo ka më shumë sosh, kërkohet të heqë dorë nga ato, atëherë do të vijë koha kur ai do të ndiejë se ideologjia të cilën ai e ka, është pjesë përbërëse e tij nga e cila s'mund të heqë dorë, dhe madje do të jetë i gatshëm që për të ta flijojë edhe jetën e vet. Kjo është ideologjia aktive dhe e gjallë e tij.

Tani duhet shikuar se a thua njeriu i atillë është i gatshëm që ta flijojë edhe jetën e vet për Islamin, për lirinë, demokracinë, për komunizmin apo për nacionalizmin. Ajo për të cilën ai është i gatshëm të bëjë çdo gjë është ideologjia e tij ndonëse nuk është i vetëdijshëm për të.

Vetëm dashuria për atë ideologji e determinon sjelljen, mënyrën dhe politikën e tij, kurse të gjitha ndjenjat tjera i nënshtrohen vetëm asaj.

Disa nacionalistë supozojnë se njëkohësisht mund ta ndjekin nacionalizmin edhe Islamin. Në mesin e tyre qenë Tahtavi dhe Mustafa Kamili nga Egjipti, Namik Kamili nga Turqia, Ebul Kelam Azodi dhe Husein Ahmed Medeni nga India, të cilët mendonin se njëkohësisht mund t'i ndjekin të dy ideologjitë, duke besuar se ato mund të jenë të pajtueshme me njëra-tjetrën. Ish-kryeministri i Irakut, Abdurrahman El-Bezzazi, në librin e tij "Islami dhe populli arab," pohon se njeriu mundet njëkohësisht të jetë musliman dhe nacionalist arab. Mirëpo këto të dyja janë të papajtueshme, andaj shmangia nga rruga e njëres nënkupton edhe largimin nga tjetra. Ujin nuk mund ta përziejnë me zjarrin.

"... a nuk ka ndër ju ndonjë njeri të mençur...?"
(11:78)

Ne jemi muslimanë vetëm atëherë kur për të gjitha aspektet e jetës kemi vizion islamik. Por, në qoftë se pranojnë ndonjë vizion tjetër shoqëror ose politik, dhe nëse hudhin poshtë ndonjë pjesë të Islamit, atëherë si mund ta quajnë veten muslimanë?

"... A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni? Ç'mund të jetë ndëshkimi ndaj atij që

punon ashtu prej jush, pos poshtërimi në jetën e kësaj bote, e në Ditën e gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër..." (2:85)

Askush nuk mund të ndjekë një shkollë të huaj e të importuar dhe njëkohësisht të pohojë se është musliman. Ideja për "muslimanin nacionalist" është absurd, mu ashtu siç është ajo për "komunistin religjioz" për "kapitalistin marksist", për "paganin monoteist" apo për "nacionalistin internacionalist."

Ato janë të kundërta. Kur zgjerohet ideologjia islame, atëherë nacionalizmi shkatërrohet ndërsa kur rritet nacionalizmi, atëherë Islami asgjësohet. Njeriu nuk mund të qëndrojë mbi dy anije të cilat lundrojnë në kahe të kundërt. Për të pohuar një gjë të tillë, nevojitet që njeriu të jetë injorant, hipokrit dhe i paaftë për ta kuptuar natyrën e vërtetë të të dy shkollave.

Teoricieni i madh bashkëkohor i Islamit, Ikbali, duke iu drejtuar Mewlana Husein Ahmedit, dijetarit të mirënjohur dhe liderit nacionalist të Indisë, ka shkruar një poemë në të cilën thotë se ai, i cili bazë të unitetit e konsideron kombin dhe atdheun, nuk ka kurrfarë njohurie nga mësimet e të Dërguarit të Islamit. Njeriu duhet ta shporrë nacionalizmin dhe të gjithë "izmat" e importuar dhe t'i kthehet Islamit.

Në qoftë se këtë nuk mund ta bëjë dhe nëse i përzier të dyja, atëherë ai në fakt ka hequr dorë nga Islami dhe është bërë antiislamik. Islami paraqet një tërësi e cila ose duhet të pranohet e tillë ashtu si është, ose të flakët krejtësisht. Ne s'mund të jemi pjesërisht të kësaj dhe pjesërisht të asaj.

Ikbali në poemën e tij thotë:

"U deklarua njëherë në katedër

se kombi rrjedh nga atdheu.

Sa injorant është ai,

për rangun e Muhammedit nga Arabia.

Bashkohuni me Mustafanë

meqë ai është besimi i tërë.

Nëse nuk i bashkoheni atij,

atëherë ju jeni Ebu-Lehebë.

Ne duhet t'i thyejmë të gjithë idhujt e të gjitha zemrave, duke përfshirë këtu edhe racizmin dhe nacionalizmin, dhe ta njohim ideologjinë në të cilën besojnë të gjithë muslimanët monoteistë, kurse kriter të vetëm ta konsiderojmë vetëm Zotin, e jo vendin, gjakun apo gjuhën:

"Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thonte): Të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i fal mëkatet tona, na i mbulo të metat tona dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!" (3:193)

Detyrë e muslimanëve është lufta e paluhatshme kundër çdo shkolle dhe ideologjie tjetër, duke përfshirë këtu edhe nacionalizmin, komunizmin dhe liberalizmin. Ata duhet bërë këtë me të gjitha mjetet politike-intelektuale, dhe nuk duhet të ndalen derisa mësimi i Zotit xh.sh. të dominojë mbi jetën personale, sociale, politike, ekonomike, intelektuale dhe mbi jetën fetare të njeriut:

"Luftoni ata derisa të mos mbetet idhujtari (besimi i kotë), e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për All-llahun..." (8:39)

Nacionalizmi dhe komunizmi në kurrfarë kuptimi



nuk mund të jenë mjet për shërimin e shoqërive të sotme të sëmura e të pabaraspeshuara. Rrugëdalja e vetme është themelimi i një shoqërie monoteiste dhe krijimi i qenieve njerëzore me vizione botërore; kjo është e mundur vetëm nëpërmjet Kur'anit.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Islami dhe nacionalizmi, autor dr. Ali Muhamed Nakavi
2. Islami dhe demokracia, autor Ali Bulac
3. Komploti botëror, autor Nikola M. Nikolov
4. Aspekte Islame, autor Nexhat Ibrahimi
5. Pushteti Islam, autor Imam Homeini
6. Hikmet, Reviste Shkencore 2013
7. Perendoria Osmane, autor Halil Inalxhik
8. www.gazetaimpakt.com
9. www.today.com/sq
10. <http://www.mediaelire.net/>
11. www.dielli.net